

L I G J
Nr.8147, datë 11.9.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7758, DATË 12.10.1993 “PËR DOKUMENTIMIN
DHE MBAJTJEN E LLOGARIVE PËR TATIMET” NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7900,
DATË 8.2.1995**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7900, datë 8.2.1995, neni 5, pika “a” dhe “b” ndryshohen si vijon:

“a) Kur në rrethet që kanë filluar vendosjen e arkave regjistruese, subjektet që janë të detyruara nuk vendosin në lokalet ose njësitë e tyre arkat regjistruese, dënohen me gjobë si më poshtë:

- Subjektet e regjistruara në tatimin e vlerës së shtuar, me tridhjetë mijë lekë.
- Subjektet e tjera që nuk janë të regjistruara në tatimin e vlerës së shtuar, me pesëmbëdhjetë mijë lekë.

Kur edhe pas dënimit me gjobë subjektet nuk vendosin në lokalet ose njësitë e tyre arkat regjistruese, organi tatimor vendos pezullimin e certifikatës për ushtrimin e veprimtarisë në lokalet ose njësitë e tyre, deri në momentin e pajisjes me arkë regjistruese.

Këto sanksione zbatohen edhe për rastet kur në lokale a njësi të tjera vihen në përdorim aparate të ndryshme nga ato që janë të miratuara.

b) Kur subjektet e pajisur me arka regjistruese, nuk lëshojnë kuponin tatimor ose e lëshojnë atë me vlerë më të vogël se vlera reale, dënohen me gjobë si më poshtë:

1. Për subjektet e regjistruara në tatimin e vlerës së shtuar:

- Kur shkelja bëhet për herë të parë, me tridhjetë mijë lekë.
- Kur shkelja përsëritet për herë të dytë, me gjashtëdhjetë mijë lekë.

2. Për subjektet e tjera që nuk janë të regjistruara në tatimin e vlerës së shtuar:

- Kur shkelja bëhet për herë të parë, me pesëmbëdhjetë mijë lekë.
- Kur shkelja përsëritet për herë të dytë, me tridhjetë mijë lekë.

Në rast se gjatë dymbëdhjetë muajve të njëpasnjëshëm numri i shkeljeve të vërtetuara sipas pikës “b” të mësipërme për moslëshimin e kuponit tatimor apo të regjistrimit të një

shume më të vogël se ajo reale është më shumë se dy herë, organi tatimor zbaton edhe masën e pezullimit të certifikatës së ushtrimit të veprimtarisë për një periudhë si më poshtë:

- Për subjektet e regjistruara në tatimin e vlerës së shtuar jo më pak se nëntëdhjetë ditë dhe jo më shumë se njëqindnjëzet ditë.

- Për subjektet e tjera që nuk janë të regjistruara në tatimin e vlerës së shtuar, jo më pak se gjashtëdhjetë ditë dhe jo më shumë se nëntëdhjetë ditë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.1610, datë 19.9.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha